

**VENDIM**  
**Nr.613, datë 21.9.2004**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË**  
**SELISË SË NATO-S, BRUKSEL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në pikën 2 të vendimit nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, tek përbërja e përfaqësisë ushtarake shtohet edhe:

“- Nënoficer shofer/shoqërues nënoficer kapter”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2005.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**